



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Data 18.07.2023

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: : «Blerje pajisje kondicionimi dhe pajisje zyre»,**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT ((FPP) 30190000- 7  
furnizime dhe pajisje te ndryshme zyre / Njesi shkembim nxehtesie, pajisje kondicionimi ajri dhe  
ftohje , makineri filtrimi – 42510000-4**

**VLERA E FONDIT LIMIT: : 1 663 875 ( nje milion e gjashtëqind e gjashtedhjetë e tre mije  
teteqind e shtatedhjetë e pese) Lekë pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor \_Bashkia Berat \_ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit sipas shtojcës 8
- c. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):** Sipas përcaktimeve të bëra në Shtojcën 7 të DST-ve (Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 vitet e fundit financiare, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se jo më e vogël se 40 % e vlerës se Fondit Limit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës është brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe paraqitja e një dëshmie të lëshuar nga administrata tatimore vërteton besueshmërinë dhe kapacitetet financiare që ka një operator ekonomik ofertues nëpërmjet xhiros të realizuar në të paktën 1 (një) vit të *periudhës së kërkuar të viteve financiare*. Është e rëndësishme që ofertuesi para se të dorëzojë ofertën të kuptojë dhe të vlerësojë aftësitë/mundësitë e tij që lidhen me kapitalin e nevojshëm për ekzekutimin me sukses të një kontrate të kësaj përmase që AK po prokuron.

---

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në është bërë bazuar në nenin 43 të VKM 285/2021 'Mbi Rregullat e Prokurimit Publik' ku



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

përcaktohet se: Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare; legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, në Ligjin nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, në VKM nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, në VKM nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për 3 vitet e fundit financiare Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të VKM nr.285, date 19.05.2021, neni 43, pika 4 (shëno bazën ligjore), ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. *(Shënim: ky kriter vendoset vetëm në rastet kur vlerësohet nga autoriteti/enti kontraktor)*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”

*(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabel ose shoqëri audituese).*

### 2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limitit të kësaj kontrate *(apo shumatores së fondit limitit të loteve, nëse kontrata është e ndarë në lote dhe ofrohet për më shumë se një lot).*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se ... % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 4/b të nenit 55 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më e vogël se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Shënim: *Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.*

**2.3.2** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e FV objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 2 (dy) punonjës. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

*Ndërsa ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, duhet të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK, dokumentacionin si më poshtë:*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

- *Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën Qershor 2023.*
- *Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Qershor 2023.*

*Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8 të DST.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Numri i përcaktuar i punonjësve është përllogaritur si më poshtë: për përcaktimin e fuqisë punëtore minimale të kerkuar argumentojme se jemi bazuar në shërbimet e kerkuara sipas Termave të References. *Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë, tregon besueshmëri për autoritetin. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Numri i mesipër perkon me stafin që pritet të jete I angazhuar në keto procedura.*

### 2.3.3 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar **2(dy) teknikë** kondicioneri

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese.

*Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik për secilin pjesëtar të stafit teknik duhet të paraqesë:*

Operatori ekonomik **për teknikët** e kondicionerit, duhet të paraqesë:

Kontrata e punë/ kontrate bashkepunimi

**Argumentimi :** Kërkesa e mesipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, si dhe referuar grafikut të punimeve të hartuar nga projekt preventivuesi. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore si dhe përvojën e nevojshme për ekzekutimin e kontratës objekt prokurimit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryej shërbimet e transportit, punimet e montimit, çmontimit, provës dhe vënien në shfrytëzim të pajisjeve objekt prokurimi, në adresat e AK, përcaktuar në tabelat e DST;

**Argumentimi:** Ky kriter është përcaktuar në mbështetje të pikës 6 të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se do të mbulojë servisin e pajisjeve të ofertuara, brenda periudhës së garancisë së kërkuar nga AK, në specifikimet teknike;

- Garancia **1 (një) vit** nga dita e vënies në shfrytëzim.

#### **Garancia**

Operatori ekonomik duhet të lëshojë një deklaratë për periudhën 1 vjeçare të garancisë së mallrave që kërkohen të prokurohen e cila fillon nga data e dorëzimit të artikujve objekt prokurimi.

Gjatë kësaj periudhe, ofertuesi do të sigurojë riparimin, mirëmbajtjen dhe shërbimin pa pagesë, të defekteve për shkak të prodhimit dhe montimit.

**Argumentimi:** Neni 36, i Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 15, pika 3/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë dhe që i vlerëson mallrat 2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog përdorimi dhe skemën e plotë teknologjike të funksionimit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 4 pika 38/b, nenin 36 dhe 77 të Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik, si dhe me piken 6/b të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilën është e përcaktuar se:[...] 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:[...] b. Fotografitë apo katalogët teknikë; [...].

Duke iu referuar për analogji vendimeve të KPP-se dhe rekomandimeve të APP-se, Autoriteti Kontraktor ka gjykuar që të paraqiten katalogë/ broshura për mallrat objekt prokurimi. Paraqitja e katalogëve për mallrat, është kërkuar me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së mallrave që operatori ekonomik oferton, me specifikimet teknike të përcaktuara në DST.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

si të pranueshme për qëllimin e kërkuar. Specifikimet teknike janë vendosur në raport me natyrën e nevojave për të cilat do të përdoren ato mallra.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

### **Specifikimet teknike dhe fondi limit janë percaktuar nga komisioni i ngritur për llogaritje e fondit limit dhe hartimin e specifikimeve**

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

Në specifikimet teknike, në rastet kur është përmendur një markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik (si “Importi” ..., “Cilësi eI-rë” ..., do të pranohen ose ekuivalente”.